



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Në bazë të nenit 5, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (**Ligji i AKP-së**), dhe kapitullit 3, të Politikave Operative të AKP-së, Agjencia Kosovare e Privatizimit ("**AKP**") si administratore me mirëbesim, përcakton statusin juridik të ndërmarrjeve dhe aseteve të saj në territorin e Kosovës, në bazë të dokumentacionit dhe dëshmive në dispozicion. Lidhur me këtë, me datë **16,17,18,19 dhe 20.09.2026**, shpallë këtë:

NJOFTIM

Në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së nr. Ref. BD-234/6, të datës 25/06/2026:

Ndërmarrja "Të mirat furnizuese të ndërmarrjes Trepça" Mitrovicë/Kosovë, KPS1544/MIT167, si dhe çdo aset tjetër i kësaj ndërmarrje që do të identifikohet në të ardhmen në territorin e Kosovës janë pronë shoqërore dhe BIEN nën kompetencat administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Shënim i rëndësishëm:

Agjencia, pas përcaktimit të statusit të ndërmarrjes, e cila bie në kompetencën administrative të saj, fillon procedurën e likuidimit dhe/ose shitjes së ndërmarrjes dhe aseteve të saj. Pas përfundimit të këtij procesi, ndër të tjera, realizohen edhe pagesat nga mjetet financiare të realizuara nga shitja e ndërmarrjes dhe aseteve të saj, në favor të "Kreditorëve" dhe "Punëtorëve të Kualifikuar", deri në shumën në të cilën këta të fundit kanë të drejtë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Palët e interesuara kanë të drejtë që, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e fundit e publikimit të këtij njoftimi, të paraqesin ankesë lidhur me këtë njoftim pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Afati për paraqitjen e ankesës fillon të rrjedhë nga dita e fundit e publikimit të njoftimit në fjalë. Pas skadimit të afatit të përcaktuar, në mungesë të një ankese të paraqitur në kohë, vendimi konsiderohet i formës së prerë, përkatësisht prodhon efekt juridik në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Ligji përkatës i AKP-së mund të gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), në adresën www.pak-ks.org, si dhe në faqen zyrtare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në adresën www.assembly-kosova.org.